



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0097

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Schoolme Implementation & Consulting” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “076 Programi per mesim online” me numër të prokurimit 635-24-11811-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PEJËS”, më 07/04/2025, mori këtë:

Vendim

1. Apropohet, si e bazuar ankesa e “Schoolme Implementation & Consulting” SH.P.K. me nr. 2025/0097, e datës 06/02/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “076 Programi per mesim online”, me numër të prokurimit 635-24-11811-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KOMUNA E PEJËS”.

2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E PEJËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit “076 Programi per mesim online”, me numër të prokurimit 635-24-11811-2-2-1, ndërsa, aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 4 dhe 6, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08.11.2024, “KOMUNA E PEJËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “076 Programi per mesim online” me numër të prokurimit 635-24-11811-2-2-1, ndërsa Vendimi i Autoriteti Kontraktues është ngritur me datën 22.01.2025 për dhënie të kontratës. OE “**PBC**” SHPK.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur të hapur, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 120.630.00€.

Me 27.01.2025, OE “Schoolme Implementation & Consulting” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 30.01.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06/02/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga “Schoolme Implementation & Consulting” SH.P.K. me nr. 2025/0097 lidhur me aktivitetin “076 Programi për mesim online” me numër të prokurimit 635-24-11811-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: Operatori Ekonomik Schoolmee Implementation & Consulting SH.P.K me datën 27.01.2024, ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: “Programi për mësim online “Nr. të Prok: 635-24-11811-2-2-1 dhe nr i brendeshen 635-24-069-221 Autoriteti Kontraktues , me datën 30.01.2025 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Pejës, ju njofton se ankesa e parashtruar nga ana juaj më datë 27.01.2025 nuk mund të merret parasysh dhe është e pa bazuar për shkak të faktit se ne dosje të tenderit është kërkuar tenderi me çmimin me të ulet, por pa anashkaluar edhe specifikimet e detyrueshme për materiale digjitale, duke mos favorizuar apo diskriminuar një apo me shume operatorë.

- Implementime të platformave mësimore të licensuara nga MASHTI dhe AKK, të cilat janë të cekura në ofertën e Operatorit PBC SH.P.K në informatat e biznesit nga Agjencioni i regjistrimit të bizneseve në Kosovë. (implementimi i platformës <https://shkollat.org> për MASHTI, në kuadër të së cilës janë liferuar licencat dhe platformat e nevojshme për të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës;)cit nga informatat e biznesit

- Kemi vlerësuar dosjen e tenderit me përpikëri duke analizuar dhe bazuar në pranueshmërinë e operatoreve ekonomik ,përshtatshmërinë profesionale, kapacitetin ekonomik dhe financiar, kapacitetin teknik dhe profesional. Materialet video incizimet operatori ekonomik është i gatshëm të prezantoj në një fazë tjetër në prani të drejtoreve të shkollave të Komunës së Pejës.

Komparria PBC SH.P.K. konfirmon se do të përmbushë të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Megjithatë, në marrim përsipër që, me kërkesë të parë nga komisioni vlerësues, të kryejmë prezantimin e mostrave, në përputhje me kërkesat e aosjes së tenderit Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejnar nga sasia totale indikativë është +/-30% të përshkrimi kontrata me çmime për njësi,Konsiderojmë se janë fakte të mjaftueshme në përputhje me qëllimin dhe realizimin e projektit “Programi për mësim online “.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Schoolme Implementation & Consulting” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Vendimmarrje e bazuar vetëm në kiiteret e përzgjedhjes dhe çmimit më të ulët, pa vlerësim të specifikave të produktit të ofertuar (Nenet 25.5, 27.3, 40.2 dhe 40.6 b). AK deklaron: "Kemi vlerësuar dosjen e tenderit mepërpikëri duke analizuar dhe bazuar në pranueshmërinë e operatorëve ekonomikë, përshtatshmërinë profesionale, kapacitetin ekonomik dhe financiar, si dhe kapacitetin teknik dhe profesional."

Vlerësim i pavemendshëm i kapacitetit teknik (Neni 40, pgr. 6 dhe 7) i ngjashmërisë esenciale, mbështetjes në referenca kontraktuale. penudhes. pageses etj. Vendimmarrje për dhenie kontrate megjithë pamundësinë e vlerësimit të produktit të OE fitues (Nenet 27.3 dhe 40, pgr. 2 dhe 6), pasi nuk ka dorëzuar asnjë nga informacionet e dokumentacionit mbi produktin që kerkohen në dosje.

Vendim për vlerësim nga Komisioni të dokumentacionit dhe të produktit të kerkuar në Dosje të tenderit jo gjatë fazës së vlerësimit të ofertave por pas dhënies së kontratës (Nenet 39.5, 37 (1, 2, 3, 6), 38.3, 40.2 dhe 40.6 b). AK deklaron "Materialet video dhe incizimet operatori ekonomik është i gatshëm të prezantohet në një fazë tjetër, në prani të drejtorëve të shkollave të Komunës së Pejës."

Lejimi OE fitues të dorëzojë pas dhënies së kontratës dokumentacionin e kerkuar në dosjen e tenderit (Nenet 37 (1, 2, 3, 6) dhe 38.3), pra disa muaj pas Njoftimit për kontratë, avantazhin OE fitues dhe krijon trajtinu të pabarabartë, se dokumentacioni duhet objektivisht të pasqyrojë gjendjen ekzistuese para publikimit të kontratës.

Mosrespektimi i referencës juridike të OSHP - AK ka injoruar precedencën për rastin e ngjashëm Nr. 2024/0365, ku PBC Sh.P.K ishte OE ankues pa dokumentim të ofertes. Tenderi synon furnizimin e SHFMU-ve të Komunes me një program mësimor online të gatshëm, me mijëra materiale digjitale shkencore sipas kurrikulës së Kosovës, të cilësisë së lartë didaktike dhe audiovizuale. Ky produkt duhet të jetë i testuar dhe i implementuar më parë në SHFMU në Kosovë dhe të ketë referenca mbi ndikimin në cilësinë e mësimdhënies. Projekti vjen në vijim të realizimeve të ngjashme në komuna të Kosovës që synojnë modernizimin e arsimit, përmirësimin e cilësisë didaktike, rritjen e rezultateve në nxënie nepermjet rritjes së kuptueshmërisë dhe memorizimit të informacionit kurrikular shkencor dhe zhvillimit të kompetencave të larta mendore si dhe tejkalimin sa më shpejt të prapambetjes në testet kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht në PISA 2025.

Në sistemin arsimor ekzistojnë dy lloje projektesh digjitalizimi, të ndryshme në natyrë dhe kërkesa:

1.Digjitalizimi për menaxhimin e proceseve shkollore Ka për objekt implementimin në shkollat të softuerëve administrativë për menaxhimin e proceseve dhe informacioneve shkollore.Operatori fitues PBC Sh.p.k ka realizuar projekte të tilla në biznese dhe shkollat, ashtu si shumë kompani të tjera IT në Kosovë. Specifika të këtij digjitalizimi mund të shihen të tenderit aktualisht i hapur "Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat e Komunës së Prizrenit" 2025/622-25-129-2-1 -1 / B54-0001722.

2.Digjitalizimi në fushën e kurrikulave digjitale që është objekti i tenderit të Komunës së Pejës, ka të bëjë me kurrikulën shkollore dhe furnizimin me materiale mësimore-shkencore digjitale online për lëndët shkollore. Këto materiale mundësojnë konkretizimin e koncepteve kurrikulare në formë audiovizuale dhe interaktive, të zhvilluara sipas standardeve shkencore dhe pedagogjike. Gjithashtu, përfshihen trajnimet për përdorimin didaktik të materialeve, ku ekspertiza didaktike është thelbësore. Materialet mbahen në një bazë të dhënash në formën e një softueri, i cili funksionon kryesisht si bibliotekë digjitale, duke ofruar

qasje e shfrytezim të lehtë për mësuesit dhe nxënësit, si në klasë ashtu edhe në shtëpi.

IV VLERESIMI I PAJTUESHMERISE SE OPERATOREVE EKONOMIKE DHE OFERTAVE ME KRITERET E DOSJES SE TENDERIT OFERTA E SCHOOLME

Me 12 vite eksperience ne krijimin e kurrikulave digjitale. grupi Schoolme eshte prodhues dhe furnizues i kurrikulave digjitale online te ndertuara sipas kurrikulave te Kosoves dhe te Shqiperise, te implementuara ne qindra SHFMU, te njohura. vleresuara e kontraktuara nga institucionet shkollore. ekspertet. DKA-te. Institutet pedagogjike. MASHT. MASR dhe Unicef. Oferta e Schoolme l&C permbush secilin nga kriteret e tenderit: kapacitetet teknike (shih kontratat per projekte te ngjashme). si dhe te gjitha specifikimet e produktit. te implementimeve dhe vleresimeve (shih loginin. mostrat dhe dokumentacionin e paraqitur ne oferte). Shih listën e dokumenteve te dorezuara ne Formularin per Dorezimin e tenderit. OFERTA E PBC SHPK ;

A. Nuk përmbush kërkesat për kapacitetin teknik per projekte te natyres se ngjashme per €50000. no tri vitot para Njoftimit por kontrato. Ne projektet IT te operuara prej PBC shpk ne institucione arsimore. nuk figuron asnjë projekt ku:

- PBC te kete furnizuar materiale mësimore kurrikulare shkencore digjitale.
- te kete trajnuar perdorues per metodat didaktike te perdorimit te materialeve mesimore
- te kete operuar me SHFMU

Specifikisht. per kontratat e PBC SHPK me institucionet arsimore

1.Kontratat me institucionin e arsimit te larte ISPE (2016) dhe Qendrat kreative per shkollat o mosmo profosionalo (2019-2021) kane per objekt Implementim softuerësh menaxhues dhe nuk furnizojne permbajtje kurrikulare per SHFMU. ndaj nuk jane projekte te ngjashme me objektin e tenderit. Nuk permbushin as kushtin formal. pasi jane realizuar me heret se tri vjet para Njoftimit per kontrate.

2.Referenca nga Kolegji BCS (shkollë për kurse profesionale IT) lidhet me softuer për menaxhimin e proceseve dhe informacionit shkollor PBC SHPK nuk ka fumizuar aty kurrikula digjitale per SHFMU dhe as nuk ka reference per pagese Mbi te gjitha. deshmia nuk mund te vleresohet ne kete tender për shkak te konfliktit te interesit. pasi pronaret janë persona te lidhur me OE PBC Sh.P.K.

3.Protondimi I PBC Shpk për implomontim to platformës Shkollat.org. Autoriteti Kontraktues citon kete implementim si plotesim njeherazi edhe te kushteve te kapacitetit teknik. edhe te specifikave te Produktit te ofertuar nga PBC (fq 2 e Vendimit ndaj Kerkeses per Rishqyrtim).

Sqarojme se platforma Shkollat.org nuk është ne zoterim te PBC Sh.p.k. dhe nuk mund t'i shitet Autoritetit Kontraktor. Kjo platforme eshte ne pronesi te MASHTI dhe operon me një softuer te dhuruar nga Microsoft. Materialet digjitale te shkollat.org janë prodhuar nga mësuesit gjatë pandemisë COVID-19 dhe shkoilat e kane ne dispozicion kete platforme te MASHTI. Si rrjedhoje. involvimi i PBC Sh.p.k ne projektin shkollat org:

- ska te beje me permbushjen e specifikave te produktit te kerkuara ne Paramase. pasi shkollat.org nuk eshte produkti qe PBC oferton ne tender.

- nuk është prove e kapacitetit teknik të PBC. sepse. i.ka të bëjë me punime për implementim softueri, jo me prodhim dhe furnizim kurrikulash digjitale për SHFMU

ii.nuk mbështetet në një reference kontraktuale që të vërtetojë pjesëmarrjen dhe rolin e PBC Sh.p.k në implementimin e shkollat.org. shumën e kontraktuar. periudhën e realizimit të këtyre punimeve.

B. Oferta e PBC nuk përmbush asnjë nga kriteret dhe specifikimet e produktit të kërkuar në Paramasë dhe Dokumentin Sqarim për OE

Për neglizhencë ose për shkak të mungesës së produktit. PBC Shpk në ofertën e tij:

- Nuk ka përshkruar produktin dhe nuk ka dorëzuar listat me informacionet e kërkuara.

- Nuk ka ofruar qasje me login në produkt.

- Nuk ka dorëzuar mostër materiale apo dokumentacion që vërteton ekzistencën e produktit dhe përputhshmërinë me specifikat.

- Nuk ka paraqitur dokumentacion mbi testimet dhe implementimet e mëparshme në SHFMU.

- Nuk ka dorëzuar vlerësime të drejtpërdrejta nga përdoruesit dhe studime të ekspertëve mbi standardin. Secilin në dhe ndikimin e materialeve për përmirësimin e cilësisë në mesimdhënie dhe nxënje."

Në një tender të ngjashëm në vitin 2024. PBC Sh.p.k nuk paraqiti asnjë dokument për produktin dhe furnizimin me materiale mesimore. AK e shpalli të papërgjegjshëm me arsyetimin se "nuk ka njësi mesimore digjitale Vendimi u konfirmua nga OSHP (Rasti 2024/365) dt 05.08.2024, i cili theksoi rëndësinë e dokumentacionit për vlerësimin e ofertave.

Në të referuarin Autoritetin Komunal të Pejës edhe gjykimin e rastit 2024/365. Megjithatë, as kjo reference juridike. me forcën e gjëse se gjykuar, nuk e bëri AK-në të Pejës të kuptojë se ka detyrë ligjore që në vlerësimin e ofertave. të bazohet në dokumentacionin e dërguar nga tenderuesit, sepse çmimi me të ulet dhe deklaratimet me fjalë të Operatoreve ekonomike se do të përmbushin kërkesat, nuk përbejnë prova të ekzistencës së produktit e përputhshmërisë së tij me specifikat e kërkuara.

V. ANKESA DHE KËRKESA PËR SHQYRTIM DHE RIVLERËSIM Bazuar në shkeljet e mësipërme të kërkesave të dosjes së tenderit. të kornizës ligjore. dispozitave dhe jurisprudence të OSHP. në veçanti vendimit 2024/365. kërkojmë me respekt nga OSHP:

1.Te verifikoj nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave kishte në përzierje anëtarë me kompetencë profesionale në fushën e kurrikulave shkollore dhe nëse ata kanë bërë vlerësim të përgjegjshëm të produktit të ofertes fituese.

2.te konstatojmë se vendimi i AK për të shqyrtuar dokumentacionin dhe mostrat e OE fituese jo gjatë fazës së vlerësimit të ofertave. por pas dhënies së kontratës është i paligjshëm

3.Te anulohet vendimi i Autoritetit kontraktues

4.Te verifikoj ofertën OE fituese por:

o Perputhshmenne e projekteve te realizuara ne arsim me objektin e tenderit. rolin e OE ne to. periudhen e projektit dhe shumat e kontraktuara.

o Ekzistencen dhe cilesine e produktit te ofruar.

o Ekzistencen dhe Vlefshmërinë e dokumenteve per permbajtjen dhe cilesine e produktit

o Ekzistencen dhe Vlefshmerine e References dokumentare per perdorimin e korikules se tij audiovizuale per SHFMU në shkolla ne Kosove.

o Ekzistencen dhe Vlefshmerine e references dokumentare deshmi dhe studime. lidhur me ndikimin pozitiv të kurrikules se tij digjitale ne mësimdhënie dhe mesimnxenie te konstatojo mungoson o dokumontaclonit dho paporputhshmorinë ë ofertës së PBC më kërkesat e tenderit dhe si rrjodhim ta shpall te pa mpergjegjshem.

6Altemativisht te udhezoje AK-ne per rivlerësimin e ofertave, duke percaktuar qarte kriteret e procedurat per rivleresim, me qellim qe ta ndihmoje per nje proces vleresimi te drejte e profesional sepse dukshem ne kete tender kaq te rendesishem per shkoilimin e 12 mije nxenesve te Komunes. Njesia e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues ka nje problem moskuptimi.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim (Nenet 25.5, 27.3, 40.2, 40.6, 40.7) – Kontrata u dha bazuar vetëm në çmim dhe kriteret e perzgjedhjes, pa vlerësim te specifikave teknike te produktit. AK: "Kemi vlerësuar dosjen e tenderit me përpikëri duke analizuar dhe bazuar në pranueshmërinë e operatorëve ekonomikë, përshtatshmërinë profesionale, kapacitetin ekonomik dhe financiar, si dhe kapacitetin teknik dhe profesional." 2. (Neni 40.6, 40.7) – Mospermbushje e kriterëve te kapacitetit teknik te OE fitues per projekte te natyres se ngjashme. Argumentimi ne Piken IV. 3. Shkelje te procedurave te vleresimit te ofertave dhe trajtim i pabarabartë në vlerësimin e ofertave. Në kundërshtim me nenet 27.3, 39.5, 39.6, 37.1, 37.2, 37.3, 37.6, 38.3, 38.5, 40.2 dhe 40.6b, Autoriteti Kontraktor (AK) ka dështuar të vlerësojë përputhjen e produktit të OE fitues me kriteret e tenderit, të përcaktuara në Paramasë dhe Sqarime për OE. Argumentimi i SchoolMe I&C mbi mungesën e dokumenteve të kërkuara në ofertën e OE fitues u shpërfill me përgjigjen: "Materialet video dhe incizimet operatori ekonomik (fitues) është i gatshëm t'i prezantojë në një fazë tjetër, në prani të drejtorëve të shkollave të Komunës së Pejës."

a. Kjo tregon ose mungesën e ekspertëve të fushës në Komisionin Vlerësues (pedagogë, drejtorë shkollash, ekspertë të DKA-së apo Institutit Pedagogjik) ose qe AK nuk ka dashur te behet vleresimi dhe konstatimi nga Komisioni i papergjegjshmerise se ofertes se PBC Sh.P.K. b. Dorezimi dhe Shqyrtimi i mostrave dhe dokumentacionit pas dhënies së kontratës dhe muaj pas njoftimit per kontrate, është i paligjshëm. Nuk reflekton situatën reale të produktit në momentin e dorëzimit të ofertave dhe përbën një vlerësim jotransparent, kur procesi është i pakthyeshëm. Ky avantazhim dhe diskriminim jo vetëm dëmton OE SchoolMe, por edhe përjashton OE të tjerë që, në kushte të barabarta, mund të kishin ofruar çmime më të ulëta se PBC Sh.p.k.

4. Mosrespektimi i referencës juridike të OSHP. Autoriteti Kontraktor i Komunes se Pejes ka injoruar vendimin e OSHP për rastin e ngjashëm Nr. 2024/0365, ku PBC Sh.P.K, OE ankues, ishte shpallur i papergjegjshem nga AK per mungese dokumentim produkti, vendim qe u konfirmua nga OSHP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 10.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0097/25, ndërsa me datë 20.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0097 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Schoolme Implementation & Consulting ” SHPK të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Schoolme Implementation & Consulting” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0097 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1 : Pretendimi ankunor i OE ankues se është se OE i rekomanduar pr kontrat nuk ka plotësuar Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe. ose profesionale sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë si në vijim:

Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjajshme në vlerë prej 50,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat

Dëshmia 1 Nje liste e kontratave e nenshkuar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet pëishkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pianimin teknik për kontratat e piezentuara për projekte të ngjajshme. Referencat apo pranimet teknike duhet të jene ne 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë. Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në bazë të dokumenteve të dorëzuara në ofertë ka kontrata të realizuara për projekte të ngjajshme pasi që në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë janë kërkuar kontrata të ngjajshme ku Operatori Ekonomik i rekomanduar ka kontrata të realizuara si projekte të ngjajshme.

Duke ju referuar kriterit të sipër përmendur me lartë si dhe sqarimet e të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankunor i Ankuesit është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2: Operatori ekonomik ankues ka pretenduar se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka plotësuar Aneksm 1-specifikimet teknike të detyrueshme në pikat e hijezuara si në vijim:

MATERIALE MËSIMORE SHKENCORE AUDIOVIZUALE DIGJITALE PËR PROGRAMET LËNDORE ME SPECIFIKIME TEKNIKE

A. Mjet mesimor në formën e njësive mësimore digjitale për lëndët bazë dhe ato shkencore të

shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët (minimum gjysma e lëndëve mësimore-të dokumentohet para komisionit vlerësues)

a) Njësitë mësimore duhet të jenë cilësore dhe të përshtatshme për përdorim si materiale didaktike ndihmuese për konkretizimin e kurrikulës së re;

•Të përmbajnë shumicën e njësive mësimore të programit lëndor për lëndët e caktuara-të prezantohet para komisionit vlerësues)

•Të realizuara në shqip;

•Të realizuara profesionalisht në formën e videove të animuara me teknika profesionale të përparuara (mesatarja e një video mësimi 4-5 minuta-të prezantohet para komisionit vlerësues);

•Me përmbajtje të lartë konkretizuese të informacionit didaktik e shkencor

•Të shoqëruara me ushtrime ose materiale të tjera didaktike të dobishme për përdorim didaktik në klasë dhe në shtëpi

(Testa e ushtrimeve dhe materialeve ndihmëse prezantohet para komisionit vlerësues);

•Të dobishme edhe në rresirrdhërie e nxënie për nxënës me nevojë të veçantë.

b) Njësitë mësimore të jenë të vendosura në një bibliotekë digjitale në formën e një softueri

elektronik të dedikuar dhe të sigurtë online ose offline që të :

•Përmbajë n.esite mësimore të listuara konform kurrikulës dhe planprogramit të definuar nga MASHT;

•T'i bëjë të disponueshme e përdorshme për mësuesit dhe nxënësit në shkollë dhe në shtëpi.

•Cfrojë funksionalitete ndihmëse për mësimdhënien dhe nxënen si mbartje shënimesh ose dritan, diskutime etj

•Të të përdorshëm edhe në rast të mësimin online

•Çdo mësues dhe nxënës të ketë qasje në bibliotekë me profilin e tij të veçantë.

B Operatori ekonomik do të:

•Vendose në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve video-tutoriale dhe manuale në formë teksti për përdorim të Bibliotekës në mësimdhënie e nxënie:

Operatori ekonomik mund të përditësojë (shtojë njësi ose edhe lëndë mësimore gjatë interpretimit) përmbajtjet vijimisht sipas ndryshimeve të kurrikulës dhe plan programeve. Nëse shtohen njësi ose lëndë mësimore operatori ekonomik nuk do të ketë mundësi të kërkojë pagesë shtesë për atë aktivitet shtesë:

Përmbajtja dhe softueri duhet të jetë testuar e implementuar në shkolla në Kosovë dhe të ketë referenca studimore e dëshmi për rritje të cilësisë në mësimdhënie dhe nxënie. Eksperti shqyrtues sqaron se dosja e tendent për shërbime nuk e përban nën 3.1 të FDT-jë, në hdhje me deklaratën për specifikime teknike të detyrueshme.

Në këtë dosje të tendent tek Aneksi 1 i dosjes së tendent janë përcaktuar disa pika thuhet “ të dokumentohet para komisionit vlerësues; të prezantohet para komisionit vlerësues ” Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë në Aneksin 1 Specifikacionet teknike të detyrueshme e ka nënshkruar dhe vëlosur dhe me këtë konfirmon se i plotëson specifikat teknike të kërkuara në aneksin 1 të dosjes së tenderit

Te Aneksi 1 i dosjes së tenderit ku janë përcaktuar disa pika thuhet “ të dokumentohet para komisionit vlerësues; të prezantohet para komisionit vlerësues ” nuk janë kriteret kualifikuese pasi që në specifikacionet teknike është kërkuar të dokumentohet para komisionit vlerësues të prezantohet para komisionit vlerësues pasi OE i rekomanduar ka deklaruar si në vijim:

Savija e parashikuar është vetëm sad Indikative. Devijimi i kësaj nga savija totale indikative është +/-30% të përshkrimi kontrata me çmime për njësi,

Nga foto si më lartë citat “ Kompania PBC SHPK konfirmon se do të përmbushë të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit si dhe Megjithatë, ne marrim për siper që me kërkesën e parë të nga komisioni vlerësues, të kryejmë prezantimin e mostrave në përputhje me kërkesat e dosjes së tendent ” nga vërehet që ofertuesi i rekomanduar për kontratë ka qenë i gatshëm për prezantim me kërkesë të komisionit të vlerësimit ku është e nënshkruar dhe e vëlosur nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë Aneksi 1 i dosjes së tenderit.

Operatori Ekonomik ankues i referohet edhe një Vendim të OSHP me nr 2024.365 të datës 05.08.2024 mirëpo dallimi i kësaj raste me vendimin e datës 05.08.2024 dallon pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka nënshkruar dhe vëlosur Aneksin 1 të dosjes së tenderit si dhe duke theksuar Kompania PBC SHPK konfirmon se do të përmbushë të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit si dhe Megjithatë, ne marrim për siper që me kërkesën e parë të nga komisioni vlerësues, të kryejmë prezantimin e mostrave në përputhje me kërkesat e dosjes së tendent ”.

Duke ju referuar kriteret të sipërpermendura më lartë si dhe sqarimeve të dhëna më lartë, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi ankues i Ankuesit është pjesërisht i pa bazuar. Çmimi i ofruar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë është 74,187.45€, ndërsa çmimi i Operatorit Ekonomik ankues është 120,630.00€, e që në fakt Operatori Ekonomik ankues është ofertuesi më i shtrenjtë në këtë aktivitet të tenderit që do të thotë se çmimi i ofruar nga Operatori Ekonomik ankues është sa vlera e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit prej 120,630.00€. Nga kjo vërehet se dallimi në mes OE të rekomanduar për kontratë dhe OE ankues është në vlerë prej 46,442.55€ ku Autoriteti Kontraktues ka ruajtur buxhetin në vlerë prej 46,442.55€. Atëherë kur kemi parasysh Nenin 6 të LPP-së e që është ekonomiciteti dhe ruajtja e parasë publike, e që ky është edhe parim kryesor i LPP-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret ka pasur nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 2 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ka qenë e nevojshme të dëgjohen edhe palët.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, dhe deklaratat e palës ankuese të dërguara me email si dhe të dërguara edhe në seancën ndëgjimore të datës 04.04.2025, në të cilën morën pjesë vetëm ankuesi, pasi që për herën e dytë radhazi as përfaqësuesi i AK por edhe as eksperti shqyrtues nuk morën pjesë në këtë seancë, Vlen të theksohet se kjo seancë është mbajtur pasi që dy herë radhazi është shtyrë. Paneli Shqyrtues i kësaj lënde në këtë seancë por edhe në këtë vendim ju shqiptoj vërejtje ZPP dhe ekspertit shqyrtues për mos pjesëmarrje në këtë seancë. Posaçërisht, ZPP i cili në thirrjen e fundit as që kthen përgjigje rreth mundësisë për pjesëmarrje apo jo.

Gjatë kësaj seancë pala ankuese para panelit prezantoi të gjithë dokumentacionin dhe para panelit elaboroi dhe shpjegoi edhe në mënyrë vizuale dhe përmes videove se si duket një program i mirëfilltë dhe i kompletuar sipas kërkesave të DT të hartuara nga AK, në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë ku sipas tyre (ankuesit) OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar produkt që plotëson specifikat teknike. OE nuk ka dhënë asnjë informacion apo përshkrim të produktit dhe nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat 1-10 (shih listen me poshtë në aneks) për produktin të kërkuar tri herë me dosjen e tenderit, në Aneksin 1, Paramasë dhe Sqarime shtesë. pastaj Mungon Dokumentimi 11, plotësimi i kriterit të kapacitetit teknik, OE nuk ka deshmuar aftësi relevante për Projekte të natyrës së ngjashme, sepse: a. Asnjë prej projekteve të paraqitura nuk plotëson kriterin e kapacitetit teknik lidhur me aftësitë për krijuar Kurrikula shkollore për

SHFMU (sipas references ISTE) apo eksperiencia trajnuese per aspekte metodologjike te mesimdhenies dhe mesimnxenies.. b. Shumica e projekteve te listuara nuk kane perputhje kohore, shuma kontraktuale dhe referenca kontraktuale. c. Kemi argumentuar qe projekti shkollat.org i cituar nga AK nuk e permbush kriterin, sepse eshte jashte kuadrit kohor (2020), nuk ka shume kontraktuale, reference kontraktuale, i referohet vetem implementimit te softuerit te dhuruar nga Microsoft, nuk ka te beje me prodhim prej PBC te kurrikulave shkollore. Konstato direkt te shkollat.org deklarimin e MASHTI. Autoriteti Kontraktor eshte mbeshetur tek projekti shkollat.org per te provuar se OE i rekomanduar per kontrate i permbush kriteret e kapacitetit teknik. Kemi Verejtur gjithashtu qe, ne tenderin e shqyrtuar nga OSHP 2024/365, oferta PBC u deklarua e papergjegjshme sepse nuk i kishte njesite mesimore dhe nuk kishte dorezuar asnje dokument. Sjellja e OE, dergimi i ofertave te padokumentuara duke pretenduar se eshte pergjegjesi e AK per t'ia kerkuar vecanerisht, eshte perseritur ne tenderin e Pejes. Nuk behet fjale per paqartesi, por per mungese produkti ose mungesa thelbesore te Ofertes, qe e bejne oferten e PBC te papergjegjshme. 4. Nese kjo praktike tolerohet, i mundesohet te gjitha kompanive qe te dergojne oferta te padokumentuara me cmimin sa me te ulet, pa asnje garanci pergjegjshmerie lidhur me specifikat e dosjes se tenderit dhe te shpallen fituese me cmimin me te ulet.

Paneli Shqyrtues te gjitha keto pretendime ankimore te ankuesit i kualifikon si te bazuara per shkak se OE i rekomanduar per kontrate nuk i ka permbushur kerkesat e DT dhe AK nuk ka respektuar nenet perkatese per vleresimin e ofertave konkretisht nenin 59 te LPP. Sipas vleresimit te ketij Paneli Shqyrtues konsideron se eksperti shqyrtues nuk eshte leshuar fare rreth permbajtjes se projekteve te ngjashme te realizuara nga OE i rekomanduar per kontrate, ngase, nisur nga natyra e ketij aktiviteti te prokurimit OE i rekomanduar nuk ka prezantuar asnje projekt te ngjashem lidhur me krijimin e njësive mësimore apo furnizim me materiale mësimore audio vizuale-digjitale, por vetem ne implementim apo krijim të softuerëve, kjo vërtetohet edhe nga referencat e ofruara nga vetë OE i rekomanduar, ku asnjëra prej këtyre projekteve nuk dëshmon se ka ndonjë ngjashmëri me këtë projekt të përshkruar edhe në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit dhe kërkesës së DT. Kështu që, pretendimi i ankuesit kualifikohet i bazuar..

Paneli Shqyrtues po ashtu e konsideron si të bazuar edhe pretendimin ankimor lidhur me atë se OE i rekomanduar nuk ka ofertuar sipas kërkesave të DT, ngase OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë lloj produkti për këtë aktivitet të prokurimit përveç certifikatave të biznesit, sigurisë së tenderit, listën e çmimit, FDT dhe listës së projekteve të realizuara me referenca, është për tu habitur fakti se AK dhe komisioni i vlerësimit a është në dijeni se çfarë programi ka vendos të përzgjedh, sepse kjo nuk është e njohur as për këtë Panel. Nisur edhe nga Lista e çmimeve të cilën e ka hartuar AK dhe OE i ka vendosur çmimet por edhe nga Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, duke filluar nga:

Mjet mesimor në formën e njësive mësimore digjitale për lëndët bazë dhe ato shkencore të shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët (minimum gjysma e lëndëve mësimore-të dokumentohet para komisionit vlerësues). Sipas ketij specifikimi teknik secili OE ka qene i obliguar qe ta ofroj ne ofertën e tij këto lëndë dhe prej tyre minimum gjysmën e lëndëve të ofroj para komisionit

vlerësues, PSH konstaton se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë jo që nuk është ofruar gjysma por as edhe një e tillë, dhe nuk ka asnjë lloj dëshmie se janë ofruar edhe para komisionit të vlerësimit. Lidhur me këto AK është në dijeni se nëse të njëjtat nuk janë në ofertë atëherë si ka mundësi ato të sjellën pas hapjes, sepse kjo pastaj do të paraqiste ndryshim material të ofertës, që është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Të përmbajnë shumicën e njësive mësimore të programit lëndor (minimum 80 % e mësimëve kurrikulare për lëndët e caktuara-të prezantohet para komisionit vlerësues). Gjithmonë nisur sipas këtij specifikimi teknik secili OE ka qenë i obliguar që ta ofroj në ofertën e tij produktin i cili përmban shumicën e njësive mësimore dhe prej tyre minimum 80% të prezantohen para komisionit vlerësues, PSH konstaton se në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë jo që nuk është ofruar 80% por as edhe një, dhe nuk ka asnjë lloj dëshmie se janë ofruar edhe para komisionit të vlerësimit.

Sipas bindjes së PSH njëjtë qëndron edhe në pikat tjera të kërkuara përmes specifikimit teknik andaj është i qëndrueshëm edhe fakti se kjo ka ndërlidhje po thuajse identike edhe me rastin e vendimit tjetër të nxjerr nga OSHP me nr. 2024/365.

Nisur nga të gjitha këto konstatime, Paneli Shqyrtues vlerëson si të bazuar ankesën e OE ankues anulon njoftimin B58, ndërkaq aktivitetin e Prokurimit “Programi për mësim online” me nr. të prokurimit: 635-24-11811-2-2-1, të iniciuar nga AK Komuna Pejë, të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim. AK gjatë fazes së ri-vlerësimit të veproj konform dispozitave ligjore dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli po ashtu, ka vendosur në përputhje edhe me nenin 23, paragrafin 10 të Rregullores së Punës së OSHP nr. 83/20, në kuptim të nenit 107 të LPP dhe sipas nenit 116, paragrafit 5 të LPP: *“Nëse cilado palë në procedurë dështon ose refuzon që të marrë pjesë plotësisht në procedurat ose që të përmbushë kërkesat e kësaj Pjese IX, Rregulloren e Punës që përshkruhet në nenin 107 i këtij ligji, ose një urdhër të nxjerrë nga OSHP, paneli shqyrtues e merr vendimin në bazë të provave që i ka në dispozicion dhe në bazë të argumenteve të sjella nga palët me pjesëmarrje aktive në procedurë. OSHP është i autorizuar ta trajtojë (zgjidhë) refuzimin ose dështimin e tillë, siç e sheh të arsyeshme, duke: (i) vendosur mbi çfarëdo çështje ligjore dhe/ose çështje faktike në favor ose kundër palës kundërshtuese, dhe/ose (ii) vendosur mbi çfarëdo pretendimi në favor ose*

kundër palës kundërshtuese”.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - Schoolme Implementation & Consulting SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: